



REPUBLICA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO		AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT	
AGJENCIA PROTIV KORRUPCIE		ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep.	DPKI	Nr Prot	
Dep.		By Prot	06-865/20
Dep.		Prot No	
Nr. I faq		Data	
Broj stranica	02	Datum	28.04.2020
Nr. pages		Date	
PRISHTINE			



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT  
AGJENCIA PROTIV KORRUPCIE  
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të nenit 11, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1, nenit 5, paragrafi 1 pika 1.5, nenit 18, paragrafi 10 dhe 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, si dhe nenit 7 paragrafi 4 të Rregullores nr. 01/2018 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores Nr. 01/2014 dhe Rregullores Nr. 01/2017 të Punës së Agjencisë Kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 23.04.2020, mori:

**V E N D I M**

- I. Mbyllet rasti me Nr. *AKK-DPKI-06/2841/19*, për zyrtarin e lartë z. Robert Tunaj, Gjyqtar në Gjykatën Themelore në Prizren - Dega në Suharekë, për shkak së është shmangur gjendja e papajtueshmërisë, përkatësisht konfliktit të interesit në ushtrim të funksionit publik.
- II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë në rast se paraqiten rrethana të reja.

**A r s y e t i m**

I. Në rastin e shqyrtuar për konflikt të interesit me numër protokolli *AKK-DPKI-06/2841/19*, që për trajtim ka pasur zyrtarin e lartë z. Robert Tunaj, Gjyqtar në Gjykatën Themelore në Prizren - Dega në Suharekë, është zhvilluar procedura e paraparë sipas Ligjit nr.06/L-011 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik.

Agjencia kundër Korrupsionit (në tekstin e mëtutjeshëm: Agjencia), pasi ka identifikuar rastin për zyrtarin e lartë z. Robert Tunaj, Gjyqtar në Gjykatën Themelore në Prizren - Dega në Suharekë, ka verifikuar informacionin ku i njëjti figuronte si Person i Autorizuar në biznesin privat " Robert Tunaj " B.I, fillimisht, me shkresën zyrtare *DPKI-06-2564/19*, ka kërkuar nga Agjencia e Regjistrimit të Bizneseve në Kosovë (në tekstin e mëtutjeshëm: ARBK), verifikimin dhe konfirmimin e informacionit lidhur me biznesin e cituar mësipër. Nga përgjigja e ARBK-së (shkresa zyrtare nr. *DPKI-06-2564/19*), rezulton se zyrtari i lartë z. Robert Tunaj është person i autorizuar në biznesin në fjalë.

Agjencia në pajtim me nenin 22, paragrafin 3 dhe 5 të Ligjit nr. 06/L-011 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik, e ka njoftuar zyrtarin e lartë për fillimin e



shqyrtimit të gjendjes së konfliktit të interesit, përmes shkresës zyrtare AKK-DPKI-06/409/20, dhe se në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të kësaj shkrese, ai ka të drejtë të njoftohet gjerësisht me faktet që posedon Agjencia lidhur me rastin në fjalë.

Pas pranimit të kësaj shkrese nga pala, me kërkesë të tij është organizuar dhe mbajtur një takim brenda Agjencisë, ku zyrtari i lartë është njoftuar gjerësisht lidhur me faktin se, ushtrimi i funksionit të Gjyqtar si dhe të qënurit njëkohësisht Person i Autorizuar në biznesin privat, paraqet gjendje të papajtueshmërisë me ushtrimin e funksionit publik, situatë e cila është në kundërshtim me nenin 13, paragrafi 1 të Ligjit nr. 06/L-011 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik, ku përcaktohet se:

*“Zyrtari i lartë nuk mund të jetë menaxher, përfaqësues i autorizuar ose anëtar i ndonjë organi menaxhues apo mbikëqyrës i personave juridikë privatë, fitimprurës sipas ligjit përkatës për shoqëritë tregtare dhe organizatave joqeveritare, përjashtuar subjektet e përcaktuara në nenin 14 të këtij ligji, subjektet politike si dhe rastet kur një funksion i tillë i dedikohet me ligj për shkak të funksionit”.*

Pas diskutimit dhe ballafaqimit të fakteve, zyrtari i lartë z. Robert Tunaj, është pajtuar me gjetjet e Agjencisë, duke prezantuar fillimisht vendimin mbi shlyerjen nga Regjistri i Odës së Avokatëve (OAK) të Kosovës, Nr. 1130/2010, të datës 03.11.2010, si dhe duke deklaruar se që nga nxjerrja e këtij vendimi nga ana e OAK-së, dhe emërimit si Gjyqtar, nuk ka ushtruar asnjë lloj veprimtarie me biznesin në fjalë. Gjithashtu zyrtari i lartë ka deklaruar se do të ndërmarr veprime tjera konkrete në mënyrë që të shmang papajtueshmërinë në ushtrimin e funksionit publik.

Me datë 13.03.2020, Agjencia ka pranuar shkresë zyrtare me të cilën dëshmohet se zyrtari i lartë z. Robert Tunaj, ka bërë shuarje vullnetare të biznesit dhe i njëjti nuk figuron më të jetë Person i Autorizuar e as pronar i biznesit privat “ Robert Tunaj ” B.I.”.

Me veprimet e ndërmarra nga zyrtari i lartë z. Robert Tunaj janë krijuar rrethana të reja me çfarë është shmangur gjendja e papajtueshmërisë, përkatësisht e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik, andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

II. Në mbështetje të nenit 18, paragrafi 11 të Ligjit Nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPKI- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)

Shaip Havolli  
Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit

